



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:281727
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06889467

C. nr. 4929/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Atdhe Berisha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.M., S.I.H., F.K., E.Z. dhe B.B. të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.S. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensim për shkak të inflacionit, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 18 Shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia paditësve R.M., S.I.H., F.K., E.Z. dhe B.B. kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë :

Paditësi R.M.

1. Për periudhën kohore Dhjetor 2020 në shumën prej 0.43 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 87.72 euro;
3. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 266.85 euro; apo shumën e përgjithshme prej 355 euro.

Paditësja S.I.H.

4. Për periudhën kohore Dhjetor 2020 në shumën prej 0.84 euro;
5. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro;
6. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.54 euro; apo shumën e përgjithshme prej 695.14 euro.

Paditësja F.K.

7. Për periudhën kohore Dhjetor 2020 në shumën prej 0.43 euro;
8. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 87.72 euro;
9. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 266.85 euro; apo shumën e përgjithshme prej 355 euro.

Paditësja E.Z.

10. Për periudhën kohore Dhjetor 2020 në shumën prej 0.43 euro;
11. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 87.72 euro;
12. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 266.85 euro; apo

shumën e përgjithshme prej 355 euro.

Paditësja B.B.

13. Për periudhën kohore Dhjetor 2020 në shumën prej 0.84 euro;

14. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro;

15. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.54 euro; apo shumën e përgjithshme prej 695.14 euro.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve të ua paguaj shumën e përgjithshme prej 2,455.28 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (15.12.2023), e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 352.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesë padisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të këtij dispozitivi.

A r s y e t i m

Paditësit R.M., S.I.H., F.K., E.Z. dhe B.B. të gjithë nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 15.12.2023, përmes të autorizuarve të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Mati Logoreci” në Prizren, ku të njëjtet kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë, e referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në nenin 35 par.10, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Tutje është theksuar se duke i marrë për bazë dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit, nënkupton që paditësve që prej 01.01.2020 deri më datë 22.11.2022, në vahdimësi iu ka takuar që të kompensohen shtesë në pagën e tyre, kjo shtesë sipas rritjes së inflacionit, mirë paditësit deri më sot nuk janë kompensuar për këtë të drejtë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 17.12.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtës së saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së

punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar. Po ashtu theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2020 është parashkruar sipas nenit 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve të refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Vërtetimet për paditësit të lëshuara nga këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “ Mati Logoreci” në Prizren, poashtu në vërtetimet e lëshuara vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Paditësi R.M.

- Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.43 euro ($215 \cdot 0.2\% = 0.43 \cdot 1 \text{ muaj} = 0.43$ euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%,

ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 87.72 euro ($215 * 3.4\% = 7.31 * 12 = 87.72$ euro).

- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 266.85 euro ($215.00 \times 11.6\% = 24.94 \times 10$ muaj = 249.40 euro) + 21 ditë * 0,83 = 266.85 euro.

Paditësja S.I.H.

- Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.84 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 1$ muaj = 0.84 euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësen në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 = 171.76$ euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54 euro ($421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10$ muaj = 488.36 euro) + 21 ditë * 1,62 = 522.54 euro.

Paditësen F.K.

- Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.43 euro ($215 * 0.2\% = 0.43 * 1$ muaj = 0.43 euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësen në vitin 2021 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 87.72 euro ($215 * 3.4\% = 7.31 * 12 = 87.72$ euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 266.85 euro ($215.00 \times 11.6\% = 24.94 \times 10$ muaj = 249.40 euro) + 21 ditë * 0,83 = 266.85 euro.

Paditësen E.Z.

- Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.43 euro ($215 * 0.2\% = 0.43 * 1$ muaj = 0.43 euro).

euro).

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësen në vitin 2021 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 87.72 euro ($215 \times 3.4\% = 7.31 \times 12 = 87.72$ euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 215.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 266.85 euro ($215.00 \times 11.6\% = 24.94 \times 10$ muaj = 249.40 euro) +21 ditë * 0,83=266.85 euro.

Paditësja B.B.

- Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.84 euro ($421 \times 0.2\% = 0.84 \times 1$ muaj = 0.84 euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësen në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 = 171.76$ euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54 euro ($421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10$ muaj = 488.36 euro) +21 ditë * 1,62=522.54 euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që : *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 15.12.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 01.12.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 11 muaj, ashtu që paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar

realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë dhe atë më datë 15.12.2023. Ndërsa me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 15.12.2023 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 15.12.2020 e deri më 21.11.2022, gjykata konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin dhjetor 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtit kanë pranuar pagën e muajit nëntor 2020, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht të njëjtit atëherë janë njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin nëntor 2020 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht dhjetor 2020, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditëses nga fillimi i muajit dhjetor 2020 ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.12.2020 e deri më 21.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (15.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të tjera të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 352.00 euro. Gjykata, e refuzoj pjesën tjetër të kërkesës sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 4929/23, datë 24 shkurt 2025

G j y q t a r i
Atdhe Berisha

Numri i lëndës: 2023:281727
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06889467

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.